

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E HËNË 3 TETOR 2022

Të dashur kolegë,

Të dashur qytetarë,

Lezha është një ndër qarqet me fushat më pjellore në të gjithë ultësirën perëndimore, një qark me potencial zhvillimor ekonomik, por po të kishte vëmendje, mbështetje dhe investime do të prodhonte kultura të ndryshme bujqësore, të cilat jo vetëm do të ndikonin në ekonominë familjare, por edhe në ekonominë e përgjithshme të Shqipërisë. Në realitet situata është krejt ndryshe, në fakt, është e trishtë, sepse Lezha, në statistikat e viteve të fundit, renditet nga vetë INSTAT-i ndër qarqet më të varfra të Shqipërisë. Mijëra hektarë tokë janë lënë djerrë në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë së Lezhës dhe jo vetëm, por në të tria bashkitë e qarkut të Lezhës.

Gjithë ky potencial ekonomik nuk përkthehet në para dhe nuk prodhon të ardhura e mirëqenie për familjet. Nuk ka fonde, nuk ka institucione, nuk ka mbrojtje, nuk ka nxitje, që, nëse punon apo nëse merr iniciativa do të gjesh mbështetje dhe përkrahje nga ata që mbledhin taksa dhe tatime për t'u shërbyer njerëzve në të gjithë Shqipërinë. Pra, situata është totalisht demoralizuese për Lezhën, në Balldren, në Zadrimë, në Bregun e Matës, në Zejmen, në Shëngjin e në Shënkoll, ku fermeri është lënë në harresë, pasi kostoja e punimit të tokës, e farërave apo e helmeve bujqësore është tejet e lartë. Çmimet janë shtrenjtuar e po shtrenjtohen çdo ditë. Por çfarë ka bërë qeveria shqiptare për të amortizuar, ose për të kuruar efektin e çmimeve dhe të kostove të rritura?

Nuk ka bërë asgjë, ka bërë vetëm propagandë, duke na thënë që këto ndodhin kudo nëpër botë. Edhe në rastet kur fermeri ka tentuar të sfidojë kostot, tregu e ka ballafaquar me mungesa të mëdha, pasi qeveria i jep akses mallit të importit para se të sigurojë tregun për prodhimet vendase. Para pak ditësh media solli rastin në Zadrimë, ku shumë familje që kanë

ndërtuar vreshtari dhe kanë rritur prodhimin, nuk sigurojnë dot tregun e shitjes. E njëjta situatë është edhe për të gjitha prodhimet e tjera. Në fushën e Torovicës, e njohur për prodhimin e bostanit, aktualisht që po flasim, me mijëra kuintal bostan po kalben atje, munda dhe djersa e fermerëve lezhjanë po nëpërkëmbet nga qeveria, e cila gënjen në teori, por ngel në klasë në përballje me fermerët.

Në takimet që pata me disa fermerë pashë që kishin shqetësim subvencionimin e naftës, shumë prej tyre nuk kishin fare informacion për praktikën e aplikimit, ndërsa institucionet nuk kanë kohë t'u shkojnë në ndihmë në fshatra të ndryshme me fushata informuese. Në këtë situatë, autoritetet duhet të zbresin në terren, që të shohin gjendjen e fermerit dhe ta ndihmojnë atë realisht me vepra e jo me fjalë. Në këtë kohë tragjike që po kalojmë, kur emigrimi po bën kërdrinë, dhe për këtë është përgjegjëse vetëm kjo qeveri, lind domosdoshmëria nga të gjithë për të përkrahur fermerin lezhjan dhe shqiptar, që të mos zhbëhet fshati.

Një tjetër problematikë, që po merr përmasa shqetësues vit pas viti, është ndotja e lumit Drin, problematikë kjo që duhet të shqetësojë mbi të gjitha Ministrinë e Mjedisit. Është detyrë e kësaj qeverie, e këtyre ministrave dhe e drejtorive përkatëse që të merren me këto problematika, se për këtë paguhen. Lumi Drin, nëse mund të quhet akoma i tillë, pasi sot është shndërruar në një kanal mbetjesh dhe ujërash të zeza, që prej nga buron e deri në derdhjen në det, kalon mospërmasë qytetit të Lezhës, duke shkaktuar një masakër mjedisore dhe duke rrezikuar jetët e banorëve të zonës. Ndryshimi i situatës kërkon projekte dhe studime, nuk ndalohet ndotja me fjalime nga Tirana.

Po të shkojë tani zonja ministre në grykëderdhjen e Drinit, në Vain, do të shohë se çfarë mbetjesh shkarkohen në det. Kjo është një situatë që na prek të gjithëve dhe secili nga ne duhet të marrë përgjegjësitë që i jep ligji, për të ndalur ndotjen e madhe që dëmton turizmin dhe faunën, duke lënë mënjanë show-n dhe bujën se madhe të grumbullimit të qeseve në dorë nga punonjës të administratës! Prandaj ju bëj thirrje në emër të Lezhës e të njerëzve që jetojnë në Lezhë, që të qeverisni dhe jo të jepni shfaqje, se jeni bërë të neveritshëm! Justifikoni taksat e tatimet që u merrni qytetarëve, por mos u justifikoni me propagandë! Kuptojeni që Lezha është qarku më i varfër, ku ka familje të cilave u mungojnë edhe ushqimet bazë, u mungojnë

shërbimet minimale, u mungon siguria për të nesërmen; nuk e dinë a do të kenë një vend pune nesër, a do kenë mjaftueshëm para për ushqim apo do t'u duhet të marrin borxh?

Kuptoni se Shqipëria është vend i pasigurt, ku nuk sundon ligji, ku nuk veprojnë institucionet, por sundojnë bandat kriminale, ndaj shqiptarët po largohen çdo ditë e më shumë. 12 mijë shqiptarë janë larguar vetëm në 6 muajt e parë të vitit drejt Britanisë së Madhe. Ia keni dalë të shpopulloni Shqipërinë, të largoni rininë, pjesën më vitale, të ardhmen e vendit. Do të mbeteni në histori si qeveria e varfërisë dhe e shpopullimit dhe, nëse nuk e keni kuptuar se çfarë masakre po bëni, turp për ju. Sot askush nuk ju beson më. Faleminderit!